



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 30/15 prot.

Tiranë, më 10.07.2020

VENDIM
Nr.58, datë 10.07.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 16, DATË 12.2.2020

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 16, datë 12.02.2020, të Komisionerit, “*Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë së veprimit administrativ të lëvizjes në detyrë të nëpunës* *****”.

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet informacionit të ardhur nga nëpunësja ***** , Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është njohur me pretendimin se, me urdhrin nr.135, datë 12.12.2019, titullari i institucionit ka urdhëruar lëvizjen paralele të saj, nga pozicioni që mbante “*Specialist (me grada/tituj shkencorë)*” në Sektorin e Kontrollit Mikrobiologjik të Produkteve Shtazore, Departamenti i Mikrobiologjisë, në pozicionin “*Specialiste (pa grada/tituj shkencorë)*” në Sektorin e Kontrollit të Barnave Veterinare, Departamenti i Toksikologjisë, (kategoria IV-a), me arsyetimin e nevojës së domosdoshme për përmbushjen e detyrave funksionale të këtij pozicioni.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri, ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti duke kërkuar nga institucioni Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë të gjithë materialin shkresor që pasqyron veprimet administrative të kryera për lëvizjen paralele të kësaj nëpunëseje.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ procesi është përmbyllur me Vendimin Nr.16, datë 12.2.2020, *“Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë së veprimit administrativ të lëvizjes në detyrë të nëpunëses *****”*, në të cilin është vendosur:

*“1. Të kërkoj nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) që, për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, të organizojë dhe ndjekë procesin, nëpërmjet të cilit Drejtori i institucionit në fjalë, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr.135, datë 12.12.2019, për lëvizje paralele të nëpunëses *****”, nga pozicioni “Specialist në Sektorin e Kontrollit Mikrobiologjik të Produkteve Shtazore, Departamenti i Mikrobiologjisë” në pozicionin Specialiste (pa grada/tituj shkencorë) në Sektorin e Kontrollit të Barnave Veterinare, Departamenti i Toksikologjisë”, si akt absolutisht i pavlefshëm dhe në bazë të nenit 111, të Kodit të Procedurave Administrative, të rregullojë pasojat duke e kthyer nëpunësen *****”, në pozicionin e mëparshëm të punës, “Specialist (me grada/tituj shkencorë) në Sektorin e Kontrollit Mikrobiologjik të Produkteve Shtazore, Departamenti i Mikrobiologjisë” ”*

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin Nr. 16, datë 12.2.2020, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri, konstatoi se, institucioni ka marrë masa duke rikthyer ligjshmërinë dhe me urdhrin nr. 13, datë 10.2.2020, ka anuluar aktin nr. 135, datë 12.12.2019, duke e rikthyer punonjësen në pozicionin e mëparshëm *“Specialist (me grada/tituj shkencorë)”* në Sektorin e Kontrollit Mikrobiologjik të Produkteve Shtazore, Departamenti i Mikrobiologjisë.

Për sa u përket më sipër, arrij në përfundimin se nga ana e institucionit Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë janë zbatuar detyrat e lëna në Vendimin Nr. 16, datë 12.2.2020, *“Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë së veprimit administrativ të lëvizjes në detyrë të nëpunëses *****”*, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 16, datë 12.2.2020, *“Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë së veprimit administrativ të lëvizjes në detyrë të nëpunësës *****”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 16, datë 12.2.2020.
3. Për këtë vendim të njoftohet Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe nëpunësja *****.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha